

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-19/13

**Prishtinë,
17 shtator 2013**

Në çështjen juridike të:

M.D.

Serbi

Pala ankuese/Paraqitësi i kërkesës

kundër

H. D.

Pejë

Pala përgjegjëse në ankesë/pala përgjegjëse në kërkesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarë: Elka Filcheva- Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esma Ertezi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/160/2012 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA08840) i datës 06 qershor 2012, pas seancës së mbajtur me 17 shtator 2013 morri këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M. D. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/160/2012 të datës 06 qershor 2012 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA08840.**
- 2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/160/2012 i datës 06 qershor, 2012 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA08840.**
- 3. Obligohet ankuesi që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 (gjashtë dhjetë) euro në afatin prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 01 shkurt 2007, M. D. e ka paraqitur kërkesën në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri posedimin e pronës-lokalit afarist. Ai pretendon se ka qenë pronar i zyrës së avokatisë me sipërfaqe prej 20 m², që ndodhet në Pejë, në parcelën nr. 240/2, Zona e Kadastrës Pejë. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai e parashtrroi një vendim të Sekretariatit për Urbanizëm, Shërbime Komunale, Banim dhe Ndërtim të Komunës së Pejës – Nr. 05-353/40 i datës 12 prill 1989. Me këtë akvendim D. M. i është lejuar që përkohësisht ta vendosë një objekt montazh në ngastrën 240/2 të Zonës e Kadastrës Pejë, me dimensione 4,0x5,0 m. Këtë objekt montazhi të karakterit të përkohshëm, paraqitësi i kërkesës ka qenë i detyruar ta dislokojë sipas urdhëresës Nr. 04.1354/89 e datës 18 shtator 1989 të organit kompetent me rastin rregullimit të tokës ndërtimore me shpenzimet e veta, pa kompensim dhe pa siguruar sipërfaqe tjetër. Kërkesa është regjistruar me numër KPA08840.

Më 29 tetor 2008, pala përgjegjëse në kërkesë duke marr pjesë në procedurën e AKP-ës ka theksuar se paraqitësi i kërkesës objektin afarist e ka pasur në shfrytëzim të përkohshëm dhe se ai nuk ka të drejtë çfarëdo kërkesë pronësore-juridike. Gjatë kohës së luftës ai objekt është djegur dhe se më vonë ai e ka ndërtuar nga themeli. Shpenzimet e ndërtimit të tije kanë qenë më të mëdha se vlera e gjithë lokalit para djegies. Në cilësinë e provës ai ka paraqitur fotot e lokalit të djegur.

Më 10 janar 2012, paraqitësi i kërkesës ka kundërshtuar pretendimet e palës përgjegjëse duke theksuar se, edhe me supozim se lokali i tij është djegur ai nuk ka pasur autorizim dhe të drejtën që të investonte në rindërtimin e tij. Për faktin se ai e ka dhënë me qira këtë lokal, ai nga viti 1999 kërkon kompenzimin e dëmit në shumë prej 300 euro për çdo muaj.

Sipas të dhënave të kadastrës të datës 14 qershor 2011 për njësi të Agjencisë për Kadastër të Kosovës i dt. 14 qershor 2011 konstatohet se ngastra 240-2, të Zonës për Kadastër i Komunës së Pejës regjistrohet si pronë shoqërore e që është në shfrytëzim të N.SH. “Kosovaterans” në Pejë.

Sipas raportit verifikues i dt. 14 qershor të vitit 2011 konstaton se të gjitha dokumentet e theksuara janë verifikuar pozitivisht nga ekipi verifikues i AKP-ës.

Me 6 qershor 2008, dhe 13 tetor 2010, zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej objekti afarist dhe konstatuan që ai objekt ishte i mbyllur dhe shfrytëzohej për sallon bukurie.

Me 06 qershor 2012, Komisioni me vendimin e tij KPPC/D/C/160/2012 e hodhi kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. KKPK-ja në arsyetimin e tij thekson që paraqitësi i kërkesës sipas aktvendimit të organit kompetent ka pasur të drejtë në ndërtimin e objektit të përkohshëm dhe në shfrytëzim të përkohshëm të asaj strukture dhe se prona e kërkuar duhej të konsiderohej si një objekt i luajtshëm . Sipas paragrafit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KKPK-ja kishte kompetenca për të vendosur vetëm për pronat e paluajtshme.

Më 14 nëntor 2012, vendimi iu dorëzua M.D. dhe i njëjti ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme më 10 dhjetor 2012 (në tekstin e mëtejme: pala ankuese). Ndërkaq më 06 dhjetor 2012, vendimin e pranoi edhe H.D. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë)

Ankuesi shpjegoi që lokali afarist ishte një objekt i lëvizshëm, meqë ishte lidhur me tokën në mënyrë permanente. Prandaj, vendimi i organit të kundërshtuar i KKPK-ës është marrë me shkelje thelbësore të së drejtës procedurale dhe me zbatim të gabuar të ligjit material.

Pala ankuese kërkon nga Gjykata që ta anulojë vendimin e KKPK-ës-së sa i përket çështjes juridike dhe të njëjtën ta kthejë për rishqyrtim dhe rivendosje apo kthimin e pronës që është objekt i kërkesës si dhe kompenzimin e dëmit.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditor siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Megjithatë, ankesa është e pabazuar.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë nga Komisioni në urdhër për kthim në posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon të drejtën pronësore, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojnë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999.

Nga kjo dispozitë ligjore, rezulton se juridiksioni i Komisionit për Kërkesa Pronësore i AKP-ës, dhe rrjedhimisht i Gjykatës Supreme, është i kufizuar ekskluzivisht për zgjidhjen, gjykimin dhe vendosjen e kërkesave të së drejtës së pronësisë për pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën e paluajtshme bujqësore dhe komerciale.

Nuk është kontestuese se sipas aktvendimi Sekretariatit për Urbanizëm, Shërbime Komunale, Banimi dhe Ndërtim të Komunës së Pejës – nr. 05-353/40 i datës 12 prill 1989, palës ankuese i është lejuar që përkohësisht ta vendosë një objekt montazh në ngastrën 240/2, të Zonës Kadastrale Pejë, që është regjistruar si pronë shoqërore dhe e administruar nga Ndërmarrja Transportuese “Kosova Trans” nga Peja. Këtë objekt montazh të karakterit të përkohshëm, ankuesi ishte i detyruar ta dislokojë sipas urdhërësës së organit kompetent me rastin e rregullimit të tokës ndërtimore me shpenzimet e veta, pa kompenzim dhe pa i siguruar të drejtën në sipërfaqe tjetër.

Prandaj, nga kjo gjendje e konstatimeve faktike, Gjykata Supreme vlerëson se vendimi ankimor i Komisionit për Kërkesa Pronësore, është i drejtë dhe i ligjshëm kur ka vendosur që të hedhet si e

palejueshme kërkesa e palës ankuese për mungesë të kompetencës. Kjo, për shkak se sipas aktvendimit të organit kompetent, pala ankuese ka pasur të drejtën e vendosjes së objektit montazh dhe shfrytëzimit të përkohshëm të tij, i cili duhet të trajtohet si send i luajtshëm.

Edhe Gjykata Supreme, konsideron se prona e kërkuar, sipas dispozitës së nenit 9 paragrafi 1 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të tjera Sendore, trajtohet send i luajtshëm. Sipas kësaj dispozite ligjore, ndërtesat e përkohshme montazhe, kioskat dhe vendosja e objekteve montazhe të përkohshme, siç është rasti konkret, nuk konsiderohen sende të paluajtshme. Madje, objekti i përkohshëm nuk mund të jetë çështje e pranimi të drejtës së pronës e as që mund të regjistrohet në regjistrin e pronësisë në zyrën për kadastër. Prandaj, nga kjo rezulton se janë të pabazuara, të papranueshme dhe të kundërligjshme pretendimet e palës ankuese se objekti i përkohshëm montazh i tij është send i paluajtshëm. Vendimi ankimor nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2): € 30.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë është jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë dhe jo më gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjyqi e cakton afatin prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Neni 47 paragrafi 3 parashikon që në rast të mospagesës së tarifës brenda

afatit, pala duhet të paguaj gjobën prej 50% të shumës së tarifës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent, EULEX